

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DUKE VEPRUAR NËPËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, LIDHUR ME MARRËVESHJEN ME QEVERINË E VENDIT PRITËS”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës.

Me ligjin nr.116/2013, është ratifikuar marrëveshja me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline Ag, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline Ag, në lidhje me projektin e gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP)”.

Qëllimi i këtij projektligji është që të përfshijë në marrëveshjen me qeverinë pritëse dispozita që rregullojnë trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit TAP, kryesisht për të përfshirë zbatimin e skemës së autofaturimit në lidhje me TVSH-në e investitorit të projektit dhe kontraktorëve për sa i përket furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektligj paraqet një propozim të ri për sa i përket skemës së TVSH-së në lidhje me projektin TAP, e cila është kombinim i sistemit të autofaturimit (*reverse-charge*) dhe sistemit tradicional të aplikimit të TVSH-së. Duke marrë në konsideratë jo vetëm rimbursimin e përshpejtuar të TVSH-së për kërkesat e paraqitura tashmë nga projekti TAP, por dhe fluksin në rritje të tyre që pritet të vijojë në vitet 2018 e 2019, mendohet se është i nevojshëm rishikimi i skemës së TVSH-së dhe kalimi në skemën e sipërcituar. Pra, ky propozim, synon të ulë në parametra të menaxhueshëm shumën e kërkesave për rimbursime të TVSH-së, duke bërë të mundur që projekti TAP të mos vihet në vështirësi për financimin e punimeve.

Kjo skemë nënkupton se gjatë fazës së ndërtimit (sikurse përcaktohet në marrëveshjen me qeverinë pritëse), të gjitha furnizimet e nevojshme ndërkombëtare/të huaja dhe vendase të lidhura me projektin TAP, në nivelin e parë dhe të dytë të furnizimeve për projektin TAP do t'i nënshtrohen TVSH-së, nëpërmjet sistemit të autofaturimit. Ky sistem nënkupton që edhe pse në përgjithësi është furnizuesi i një malli apo shërbimi, personi që duhet të llogaritet dhe t'u paguajë autoriteteve tatimore çdo detyrim TVSH-je, në rrethana të caktuara, mund të jetë dhe përfituesi i furnizimit ai që është përgjegjës dhe paguan TVSH-në. Ky kalim i përgjegjësisë për të llogaritur dhe paguar TVSH-në nga furnizuesi te përfituesi i furnizimit quhet mekanizmi i *reverse-charge*.

Sipas kësaj skeme specifike, investitori i projektit identifikon kontraktorët e nivelit të parë dhe të dytë, të cilët më pas i komunikohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Nga niveli 3 i kontraktorëve e në vazhdim, parashikohet aplikimi i sistemit tradicional të TVSH-së.

Importet e kryera nga investitori i projektit ose çdo kontraktor i nivelit 1 gjatë fazës së ndërtimit, për furnizimet e mallrave që lidhen me projektin janë të përjashtuara nga TVSH-ja. Ato trajtohen si furnizime mallrash të kryera nga importuesi për veten e tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike,

Për sa u përket furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve brenda vendit nga një kontraktor i nivelit të parë ose i nivelit të dytë, vetëm përfituesi i mallrave/shërbimeve do të jetë i detyruar të paguajë TVSH-në dhe ka të drejtën e zbritjes së kësaj TVSH-je sipas rregullave të përcaktuara.

Zgjidhja është efektive në aspektin kohor dhe barra administrative kufizohet te kontrolli i kontraktorëve. Burimet që do të përdoreshin nga autoritetet tatimore

shqiptare për kontrollin e kërkesave për rimbursim mund të përdoren për kontrollin e kontraktorëve të TAP. TAP do të ndajë informacionin mbi kontraktorët me autoritetet përkatëse.

Mekanizmi i *reverse-charge* parashikohet nga direktiva e BE-së nr.2006/112/EC “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”, në nenet 194 deri 199 të saj si përjashtim ndaj rregullit kryesor që TVSH-ja është e pagueshme nga personi që kryen furnizimin. Gjithashtu, mekanizmi i *reverse-charge* është një mekanizëm që është përdorur në Shqipëri në kuadër të legjislacionit fiskal, pra, tashmë është i njohur për autoritetet shqiptare.

Marrëveshja e ndryshimit pas negociimit dhe konkludimit të projektit të dakordësuar mes palëve, në zbatim të nenit 10, të ligjit nr.43/2016, iu nënshtrua procesit të miratimit në parim nga Këshilli i Ministrave, i cili me vendimin nr.318, datë 31.5.2018, miratoi në parim marrëveshjen e ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës.

Pas miratimit në parim, në datën 8 qershor 2018, marrëveshja e ndryshimit u nënshkrua edhe nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe në harmoni me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban dy nene.

Në nenin 1 parashikohet ratifikimi i marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe

Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, sipas tekstit bashkëlidhur projektligjit.

Në nenin 2 parashikohet hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjatë fazës së miratimit në parim, e gjithë praktika, përfshirë marrëveshjen e ndryshimit u koordinua në format shkresor me ministrinë e linjës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit nuk shoqërohet me shpenzime financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE